REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, JANAR 2025						
Nr. Rendor	**Data e kërkesës**	**Objekti i kërkesës**	**Data e përgjigjes**	**Përgjigje**	**Mënyra e përfundimit të kërkesës**	**Tarifa**
1	5.1.2025	Kërkohet informacion lidhur me krijimin e një mikroshteti sovran mysliman në Tiranë, "Shteti Sovran i Rendit Bektashi".	15.1.2024	Kthim përgjigjeje se nuk ka ndonjë vendimmarrje për të krijuar një mikroshtet sovran mysliman në Tiranë, "Shteti Sovran i Rendit Bektashi".	Përfunduar	Nuk ka
2	12.1.2025	Kërkohet informacion për disa akte, nëse janë në fuqi apo janë shfuqizuar.	22.1.2025	1. Lidhur me vendimin nr.243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", të Këshillit të Ministrave, dëshiroj t'ju informoj se bazuar në vendimin nr.18/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", pika, 1, është miratuar dhënia e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur më VKM 243/2020, të sipërcituar, deri në datën 23.6.2020. 2. Lidhur me Aktin Normativ nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19", në të përcaktohet se ky akt normativ ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. 3. Lidhur me vendimin nr.1, datë 25.3.2020 "Për konfirmimin dhe vijimin e zbatimit të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19", lutem më saktësoni se cili është organi që e ka marrë këtë vendim, sepse nuk ka vendim të Këshillit të Ministrave me këto referenca.	Përfunduar	Nuk ka
3	13.1.2025	Kërkohet informacion lidhur me mbylljen e platformës Tik Tok në Republikën e Shqipërisë.	15.1.2024	Kthim përgjigjeje se nuk ka ndonjë vendimmarrje për mbylljen e platformës Tik Tok në Republikën e Shqipërisë.	Përfunduar	Nuk ka
4	20.1.2025	Kërkohet informacion në lidhje me shpërndarjen e shpenzimeve të Kryeministrisë, për periudhën 2021-2024.	22.1.2025	Në përgjigje të kërkesës, informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, studime, etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet, psh ligjin për buxhetin e vitit përkatës, 2018, 2019.. etj.	Përfunduar	Nuk ka
5	22.1.2025	Kërkohet informacion në lidhje me vendimin nr. 19, datë 9.1.2025, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me Kontratë të Përkohshme, për vitin 2025, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore".	23.1.2025	Në përgjigje të kërkesës, informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, studime, etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
6	23.1.2025	Kërkohet kopje e relacionit shoqërues të VKM nr. 223, datë 26.11.2016, të VKM nr. 1620, datë 26.11.2008, të VKM nr. 89 datë 3.2.2016, të VKM nr. 658 datë 26.9.2012 dhe VKM nr. 1034 datë 16.12.2015.	30.1.2025	Kthim përgjigjeje bazuar në nenin 17, të ligjit 9000/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".	Përfunduar	Nuk ka
7	24.1.2025	Kërkohet kopje e VKM 143/2012 "Për miratimin e listës parapraketë pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës.	28.1.2025	Dërgohet vendimi i kërkuar.	Përfunduar	Nuk ka